REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 113/26 Dt. 09.03.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 2, 3 dhe 8 të Rregullores për Transportin Rrugor në Komunën e Prizrenit nr. 001/011-171537, datë 01 dhjetor 2022, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për vlerësimin e ofertave për ndarjen e vijave të transportit publik të udhëtarëve në komunikacionin urban. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

   1.1. Përparim Shala.....kryesues,
   1.2. Asim Kokaj,.....anëtar,
   1.3. Alban Krasniqi,.....anëtar.

2. Detyrat e Komisionit janë: vlerësimi i ofertave për ndarjen e vijave të transportit publik të udhëtarëve në komunikacionin urban, konform shpalljes publike nr. ref. 05-343/16647, datë 06.02.2026, Rregulloren për Transportin Rrugor në Komunën e Prizrenit nr. 001/011-171537, datë 01 dhjetor 2022, si dhe aktet të tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.

3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Për

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Komisionit,
- Arkivës së Kryetarit.